



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, lidhur me nenin 40, paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 2, të Ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.27/2008”, e konform nenit 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.05.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

- 1.1 Me këtë vendim klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Rr. “Stadiumi i qytetit” në Suharekë, i ndihmohet me mjete financiare në vlerë prej **80,000.00€** për ushtrimin e aktiviteteve sportive.
- 1.2 Mjetet lëshohen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë e Komunës së Suharekës, mjetet lëshohen në xhirollogarin e klubit “Ballkani”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë dhe Drejtorinë për ekonomi, financa dhe buxhet në Komunën e Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr 016-21919
Me datë 30.05.2022



Kryesuesi Kuvendit

Mr. Bexhet KUÇI